



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 105 datë 29.12.2022

PËR

“MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË STREHIMIT
“SUBVENCIONI I KREDISË ”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutë, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr.22/2018, “Për strehimin Social”, vendimit nr. 361 datë 29.05.2019 “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre i strehimit, në rastet e parashikuara në ligj dhe bashkëpunimit institucional”, vendimit nr. 362, datë 29.05.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”, vendimit Nr 453, datë 03.07.2019, të Këshillit të Ministrave, Për “Masën e Subvencionit të Interesave të Kredisë dhe Procedurën e Dhënies së tij për Familjet që Përfitojnë Banesë me Kosto të Ulët, me Kredi të Lehtësuar nga Shteti”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

VENDOSI:

- 1- Miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “ Subvencionit i Kredisë” sipas Udhëzuesit Operacional, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
- 2- Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, për zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR I KËSHILLIT

ETLEVA YZO

KRYETRI I KËSHILLIT

LAVDI HASANI